



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 82, Datë 19.03.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 828/1 prot., datë 18.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828 prot., datë 05.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, për pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b, c dhe d).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k.:

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 188 rep., nr. 413 kol., datë 10.02.2026 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në Fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “HYDROSOLAR ENERGY” sh.p.k.”;
- Është pajisur me miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 3381/3 prot., datë 04.07.2025;
- Është pajisur me Vendim VNM Paraprake, lëshuar më 09.07.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “IMPLANTIT FOTOVOLTAIK”, me kapacitet 2 MW.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për vetë shoqërinë.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion të përditësuar në lidhje me mbështetjen financiare.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të saktësojë jetëgjatësinë e pritshme të centralit dhe të përcaktojë datë konkrete kur parashikon të fillojë operimi i centralit, si dhe të depozitojë një garanci për panelet që do të përdorë, në rast se ka.
- **gërma “e”**: Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme deri më 09.07.2027, por duke qenë se në shtojcën 2 ka deklaruar se viti i ndërtimit është viti 2026 dhe vetë nuk ka paraqitur ndonjë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, vlerësohet që t’i kërkohej shoqërisë ky informacion në vijim. Po ashtu, vlerësohet t’i kërkohej të bëjë saktësimin përkatës të koordinatave në lidhje me vendndodhjen e projektit, në referencë të kontratës me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI